

STATUTI

RENT SELL ALBANIA SHPK

Ne kete statut

-“Ligji” eshte Ligji Nr. 9901, dt, 14.04.2008 “Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare”

-“Statuti “ eshte Statuti i Shoqerise ;

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia

Neni I

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

(1) Sot, me 04.07.2024 une, themeluesi, kam krijuar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin, RENT SELL ALBANIA SH.P.K.

(2) Themeluesi i shoqerise eshte:

- Andi Lleshaj, lindur me 19.06.1989, atesia Fran, identifikuar me ID I90619048P dhe adrese banimi: Rr. ABAZ ERMENJI, Nd. 7; H. 9; Ap. 1; KASHAR; YZBERISH; 1050; TIRANË

Neni 2:

Objekti

Shoqeria do te kryeje aktivitetin e meposhtem :

Veprimtari ne fushen e dhenies me qera te mjeteve te transportit si makinave, motoreve, minibus, autobus, kamion, mjete lundruese etj. Veprimtari ne fushen e organizimit te guidave turistike, brenda dhe jashte vendit. Veprimtari ne import-eksport, shitjen dhe blerjen e mjeteve motorike. Veprimtari ne kryerjen e sherbimeve dhe servisit per riparimin dhe mirembajtjen e mjeteve motorike.

Neni 3:

Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqerise do te jete e pakufizuar.

Neni 4:

Selia

- (1) Selia e shoqerise ndodhet ne adresen: Rr. Loni Ligori, Pall. Miketa 2000, Kati perdhe, Dyqani 07, Lagjia 14, 1051, Tirane
- (2) Adresa e faqes se internetit e shoqerise eshte (nese ka): (nuk ka)
- (3) Adresa e shoqerise per qellime komunikimi elektronik eshte si vijon (nese ka):
rentsellalbania@gmail.com

Kreu II

Kapitali

Neni 5:

Kapitali themeltar

(1) Kapitali themeletar fillestar i shoqerise eshte 100.000 Leke. Pjesemarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e meposhtme:

1. Ortaku i vetem dhe themelues Andi Lleshaj: Zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme : 100.000 leke, qe perben 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Kontributi i ortakeve mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te laujtshme/ te paluajtshme apo te drejta)

Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapital i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para me ane te te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjyakata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njejten mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

Neni 7:

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- b) shitblerjes;
- c) trashegimise;
- d) dhurimit;
- e) cdo menyre tjeter e parashikuar ne ligj;

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve, per sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

KREU III ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emerimin e shkarkimin e administratoreve;
- d) emerimin e shkarkimin e likujduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- e) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "d" te kesaj pike;
- f) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire paraqitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se shoqerise;
- h) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- i) pjsetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- k) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- l) miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese;
- m) ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze ten je autorizimi nga nje ortak tjetër apo nje person i trete.

Administratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e pergjithshme.

Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

Neni 9

Menyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet njoftimit me shkrese ose, nese parashikohet nga statuti, me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites dhe t'u dergohet te gjithe ortakeve jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.



Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakort, per te marre vendime, pavaresisht parregullsise.

Neni 10

Kuorumi

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 per qind te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit "Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregtare", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numerit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorunit te permendur me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

Neni 11

Marrja e Vendimeve

Asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres, per ceshtje te tjera si :

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
- c) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- d) percaktimin e shperblimeve;
- e) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire paraqitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- f) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- g) miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese;

Cdo ndryshim statute duhet te depozitohet ne QKR duke pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 12

Perjashtimi nga e drejta e votes

1. Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendim per:
 - a) vleresimin e veprimtarise se tij;

- b) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij;
 - c) ngritjen e nje padie ndaj tij nga shoqeria;
 - d) dhenjen ose jo te perfitimeve te reja
2. Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi, ashtu si edhe ortaku qe perfaqeson.

Neni 13

Administrimi

- (1) Asambleja e pergjithshme emerone nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati i emerimit, eshte 5 vjet, me te drejte ripertesitjeje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.
- (2) Administratoret e nje shoqerie tregtare meme, sipas percaktimit te nenit 207 te ketij ligji, nuk mund te emerohen si administratore ten je shoqerie te kontrolluar anasjelltas. Cdo emerim i bere ne kundrshtim me keto dispozita eshte i pavlefshem.
- (3) Personat e meposhtem caktohen si Administratore te pare te shoqerise deri ne emerimin e tyre nga mbledhja e pare e Asamblese se Pergjithshme.


Te dhenat e identifikimit:
(mbiemrat, emrat, adresat):

Roland Jaho, atesia Xhaferr.

lindur me 24.10.1985, identifikuar me ID I51024045T

Adresa e banimit: Rr. Llazi Miho, banese private nr. 44, Lagjia 14, Tirane..

dhe specifikimet e nenshkrimtit:

Roland Jaho 

Neni 14

Kompetencat e administratoreve

Administratoret kane te drejte e detyrohen te :

- a) kryejne te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme;
- b) perfaqesojne shoqerine tregtare;
- c) kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
- d) pergatisin dhe nenshkruajne bliancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve , i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim;
- e) krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
- f) kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit;



- g) raportojne perpara asamblese se pergjithshme ne lidhej me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare;
- h) kryejne detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe statut;

Administratoret jane te detyruar te therrasin Asamblene e Pergjithshme ne rastet kur :

-sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojme detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.

-shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kane nje vlere me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

-shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasyrat e fundit financiare te certifikuara.

Nese asambleja e pergjithsme emeron me shume se nje administrator, ata e administrojne bashkerisht shoqerine.

Asambleja e pergjithshme mund te shkarkoje administratorin ne cdo kohe me shumice te zakonshme. Padite, qe lidhen me shperblimin e administratorit, ne baze te marredhenjeve kontraktore te punes rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

Neni 15

Pergjegjesite e administratorit

Administratori eshte pergjegjes individualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga asambleja qe i sjellin dem shoqerise, i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marreveshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese.

Pervec sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve, 14, 15, 17 e 18 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

1.a) te kryeje detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut me mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjedis;

b) te ushtroje kompetencat qe i njihen me ligj dhe ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;

c) te vleresoje me pergjegjesi ceshtjet, per te cilat meret vendim;

d) te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ato te shoqerise;

e) te ushtroje detyrat e tij me profesionalizem dhe kujdesin e nevojshem.

2. Administratori gjate kryerjes se detyrave te tij, pergjigjen ndaj shoqerise per cdo veprim ose mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregtare, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi ose mosveprimi eshte kryer me mirebesim.

3. Nese administratori vepron ne kundersizim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, sipas pikave 1 e 2 te ketij neni, eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet, qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe ti kaloje cdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane kane realizuar nga keto veprime te parregullta. Administratori ka barren e proves per te vertetuar

kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te rregullt, e sipas standarteve te kerkuara. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator, ata pergjigjen ndaj shoqerise ne menyre solidare.

4. Ne menyre te vecante, por pa u kufizuar ne to, administratori eshte i detyruar ti demshperbleje shoqerise demet e shkaktuara nese, ne kundershtim me dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" kryen veprimet e meposhtme :

- a) u kthen ortakeve kontributet;
- b) u paguan ortakeve interesa apo dividente;
- c) u shperndan aktivet shoqerise;
- d) lejon qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare, kur , ne baze te gjendjes financiare, duhej te parashikohej qe shoqeria nuk do kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet;
- e) jep kredi.

Pervec padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortaket individualisht ose se bashku, kane te drejte te ngrene padi penale kunder administratorit.

Paditesit kane te drejte te ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plote te demit qe i eshte shkaktuar shoqerise perfshire edhe demshperblimin financiar, nese eshte e nevojshme. Asnje vendim I asamblese nuk mund te pengoje ngritjen e kerkese padise kunder administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

KREU IV

Viti financiar – ekspertet

Neni 16

Viti financiar

Viti financiar i shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 17

Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjitha dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithevjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe tja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per ti shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

Neni 18

Prishja dhe Likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe:

- a) kur mbaron kohezgatja e parashikuar ne themelimin e saj;
- b) me vendim te Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit;
- d) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 “ Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”
- e) me vendim te gjykates

Ne kete rast Ortaket me marrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument prej tij emrin e likuidatorit dhe emretesen shtese “Shoqeri ne likuidim e siper”.

Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emeruar nga ortaket.

Nese ortaket nuk marrin nje vendim per emerimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, cdo person i interesuar mund ti drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

Neni 19

Riorganizimi i shoqerise bashkimi-ndarja

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesen IX te Ligjit 9901 date 14.04.2012 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”

Neni 20

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut do te zbatohen dispozitat e ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, Kodi Civil dhe cfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 21


Mosmarveshjet

Per mosmarveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per cdo mosmarveshje qe mund te linde mes Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

ORTAKU I VETEM

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

RENT SELL ALBANIA SHPK

Andi Pleshaj 

Emer mbiemer (nenshkrimi)